

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.

Nr. _____ Prot

Data _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Lidhje me energji elektrike e depove” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 31321000

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,403,472 (një milion e katërqind e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, njësia e prokurimit harton procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, me vlerë 28,069.44 (njëzet e tetë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë pikë dyzet e katër lekë.*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, te ndryshuar dhe neneve 26,30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit. Kërkesa për

plotësimit e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. Për plotësimit e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim nga Dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në të cilin parashikohet se: “Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatoreve ekonomike nuk mund të tejkalohet: (c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Ajo i shërben UKRK sh.a për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomike dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Vlera e xhiros që kërkohej është në përputhje me vlerën e përcaktuar në nenin 43 pika 2.c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2.1.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika “b”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësitë ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 4/a, e VKM nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar si më poshtë:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është sa vlera limit e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me institucione shtetërore :

- kontratë
- situacion përfundimtar
- akt kolaudimi
- formular vlerësimi

Për kontrata të realizuara me subjekte private:

- kontratë
- situacioni përfundimtar
- vertetim për realizimin me sukses të kontratës
- faturen perkatëse tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nënve 39, pika 5 dhe 55 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **30 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/a ku përcaktohet shprehimisht, citojmë: " Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë MIE/ ose MPPT/ ose MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Per Punimet e Pergjithshme të Ndertimit

- a. NP – 11 A (Ndërtime për N/Stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Argumentimi: Kategoria e kërkuar e licencës përfshin ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per - prokurimin publik" i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar. Te dhenat për licencën e mesiperme janë vendosur referuar bazes ligjore per ndertimet, ligjit nr. 8402 date 10.9.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit" të ndryshuar, neni 8 i cili percakton se "Zbatimi i punimeve te ndertimit kryhet vetem nga persona juridike, private ose publike, vendas ose te huaj, te pajisur me licencen perkatese, per zbatim punimesh ndertimore. Zbatuesi i punimeve mban pergjegjesi dhe eshte i detyruar te realizoje punimet e ndertimit, ne perputhje me lejen e ndertimit, projektin, kushtet teknike te zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet te siguroje cilesine e materialeve te ndertimit dhe produkteve te ndertimit, te cilat duhet te plotesojne kerkesat e projektit ne perputhje me standartet kombetare ose europiane.

Kategoria është kërkuar bazuar ne zerat dhe vlerat e punimeve, si me poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit sipas kategorisë përkatëse	Vlera e punimeve, sipas kategorisë përkatëse
NP 11	A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 Tub Fleksibel Φ63 Tub Fleksibel Φ75 F.V. Në tub kabëll fuqie 20 kV alumin unipolar (flat), me izolim XLPE, (1x185) mm ² F.V. Në tub dhe konstruksione kabëll fuqie 20 kV alumin unipolar (flat), me izolim XLPE,	0-20 milion lekë	

		<p>(1x185) mm²</p> <p>F.V. Terminal 20kV me kapikordë AL-CU për seksion (70÷240mm²), unipolare për ambient të brendshëm</p> <p>Kenotronim i kokave te kabllit per seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.</p> <p>F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 170</p> <p>F.V. Tuba çeliku Ø ~ 200mm</p> <p>F.V. Shirit sinjalizimi per kablo 20 kv</p> <p>Tub Kavidoto D.63 mm, PVC</p> <p>Çmotim, Spostim shtylla ekzistuese (perfshi linjen)</p> <p>F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10</p> <p>F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm</p> <p>F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement</p> <p>F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar, L=1.5m</p> <p>F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm²</p> <p>F.V. Percjelles PPV Ø 2x1.5 mm²</p> <p>F.V. Kablo kontrolli Cu pa armuar, ne mure e konstruksione, 4x4 mm²</p> <p>F.V Tubo korogato per ambjetin Jashte d63</p> <p>F.V kabell funizimi 4x16mm²</p> <p>F.V Ndricules rrugore sipas specifikimeve teknike</p> <p>F.V. Shtylla metalike konike ndricimi H=9m PAICC-3</p> <p>F.V. Ndricules Smart VP CL1 CR M-S 250Ë GG FAE 44004, me llampe 250Ë 230V</p> <p>F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm</p> <p>F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, sexion 25mm²</p> <p>F.V. Percjellesa Cu te izoluar me gome, per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, sexion 1.5mm²</p> <p>F.V. Panel shperndares ne Tension te Ulet, komplet me 1 Automat 380V,4P,330A + 3 Automate 380V,4P,250A</p>		
--	--	---	--	--

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Elektrik

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

a. 1 (një) Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder

Per te deshmuar permbushjen e kriterit 2.3.3 dhe 2.3.4 operatori ekonomik duhet te paraqese:

- Diplomë
- CV
- Kontratë pune
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën Mars-Prill-Maj 2026

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor dhe atë mbështetës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Elektrik	Ndërtime për nënstacione, gabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike
Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder	Punime topogjeodezike

2.3.5. Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/te kualifikuar, si me poshte:

- 1(nje) punonjes i cili të disponoje certifikatë si "Pergjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë“ në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurinë

dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 i ndryshuar Për miratimin e rregullores "Per sigurinë ne kantier". Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplome/certifikatë
- CV
- Kontratë pune
- Listpagesat e sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore per periudhën Mars-Prill-Maj 2026

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhe t te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me anë te këtij kriteri kërkohet qe operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme mbeshetet ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" i ndryshuar . Natyra e kontrates dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e pergatitje te posacme per vleresime te përpikta për të zgjidhur çështje qe lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen ne pune. Ne rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 eshte percaktuar se punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. Cdo punedhenës zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihmën e pare në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja percakton kerkesat minimale te sigurisë dhe ëe shendetit në punë për kantieret e përkohshem ose te lëvizshëm, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatese te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates. Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune rekomandohet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë:

- a. 2 (dy) Elektiçistë
- b. 1 (një) Teknik ndërtimi
- c. 2 (dy) punëtorë krahu
- d. 1 (një) Manovrator (ekskavatorist/automakinist)
- e. 1 (një) Shofer

Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të paraqesin:

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma/certifikata përkatëse të arsimit profesional, që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, te njohur nga Republika e Shqiperise, sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë" ose ekuivalente.

- Dëshmi kualifikimi për sigurimin Teknik
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Mars-Prill-Maj 2026

Kriteri në fazën e dorëzimit të ofertave konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhe t te permbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht bazohet në përcaktimin ligjor që kritret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 Elektracistëve, referuar natyrës së punimeve elektrike të parashikuara në preventivin e procedurës së prokurimit. Kjo kërkesë përputhet me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 Teknikëve të Ndërtimit, të cilët do të realizojnë punimet e kontratës të parashikuara në preventiv. Kjo kërkesë përputhet me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 shoferi i cili do të shërbejë për transportin e materialeve të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 1 Manovratori eskavatorist/automakinist, i cili do të shërbejë për drejtimin e minifadromës e nevojshme për realizimin e kontratës. Kjo kërkesë përputhet me natyrën e kontratës dhe punimet e parashikuara.

Është vendosur kërkesa për disponimin e 2 punëtorëve të krahut, për punë të ndryshme krahu gjatë realizimit të punimeve të parashikuara në preventiv.

2.3.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht 10 persona, numri i punonjesve duhet të disponohet për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim të leshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjesve për secilin muaj, për periudhën 3 muajore nga momenti i hapjes së ofertave (Mars-Prill-Maj 2026).
- Listpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Mars-Prill-Maj 2026).

Kriteri sa më sipër konsiderohet i përmbushur me anë të vetedeklarimit në Formularin Permbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrushmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbushe kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrushmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiencës qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendorsja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka në funksion te realizimit me sukses te kontrates.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Minifadrome me goma(bobcat apo ekuivalene)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 1
Tokmak elektrik	në pronësi ose me qira	Copë 1

Shënim: Për plotësimin e këtij kriteri gjatë fazës së dorëzimit të ofertave operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë është si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit:

b) leje qarkullimi;

c)çertifikaten e kontrollit teknik;

d)siguracionin e mjetit, (I vlefshëm).

Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet:

a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij;

b) leje qarkullimi;

c)çertifikaten e kontrollit teknik,

d)siguracionin e mjetit,(I vlefshëm).

Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi.

b) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.*

Autoriteti Kontraktor UKKO SH.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

Argumentimi: Ne bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021"Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten. Në rastin konkret për realizimin me sukses të kontratës janë kërkuar mjetet e mësipërme bazuar në natyrën dhe volumin e punimeve objekt kontrate.

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese certifikata te vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë si më poshtë:

- ISO 9001 ose ekuivalent (Sistemi i menaxhimit të cilesisë)
- ISO 14001 ose ekuivalent (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)
- ISO 45001 ose ekuivalent (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
- ISO 39001 ose ekuivalent (Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise. Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper; ose t'i kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 79, "Standardet e sigurimit te cilesise dhe standardet e menaxhimit mjedisor" te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", dhe nenin 39, te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar. Per vetë natyren e veccante, vendndodhjes dhe permasat e objektit te kontrates qe do te prokurohet, eshte teper e rëndesishme qe operatoret si zbatues, te kryejne veprimtarine me standardet e kerkuara te cilesise. Sistemi i menaxhimit te cilesie, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurise ne punë jane standarte qe cdo subjekt juridik apo privat e ka qellim ne arritjen e suksesit. Keto

certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontrates persa kohe do te pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e kapaciteteve te operatoreve ekonomike dhe te mundesise se tyre per permbushjen e plate te kontrates. Referuar ne nenin 79 te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik“ i ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund te kerkoje certifikata, te leshuara nga organe te pavarura, qe vertetojne pajtueshmerine e kandidatit ose te ofertuesit me standardet e kerkuara te cilesise, perfshire edhe standardet per menaxhimin e mjedisit, shendetit dhe sigurise ne pune. Ne rastin konkret eshte kerkuar edhe certifikata ISO 39001 ose ekuivalent (Sistemi i menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor) e cila lidhet me natyrën e objektit të prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Duke qenë se për procedurën e prokurimit është bërë një projekt paraprak nga projektuesi i licensuar nuk janë hartuar specifikime teknike më vete. Specifikimet teknike të kësaj procedure prokurimi jane të parashikuara në projektin e realizuar nga projektuesi i cili do te publikohet në SPE si pjesë integrale e dokumentave të tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT

- Grisilda Sejamini (Jurist)
- Thoma Koroveshi (Inxhinier Hidroteknik)
- Resmir Rezhda (Ekonomist)